

VENDIM
Nr. 995, datë 9.12.2015

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË BUJQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TË SIPËRFAQES SË
TOKËS BUJQËSORE PREJ 926.55 HA, NË PRONËSI SHTETËRORE, DHËNË NË
PËRDORIM KOMUNAVE BUÇIMAS, ÇËRRAVË DHE UDENISHT DHE PËR DISA
NDRYSHIME NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 244, DATË 4.4.2012,
NR. 417, DATË 8.6.2011, DHE NR. 534, DATË 1.5.2008**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, dhe të shkronjës “b”, të nenit 14, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 (nëntëqind e njëzet e gjashtë pikë pesëdhjetë e pesë) ha, në pronësi shtetërore, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi, dhënë në përdorim komunave Udenisht, Buçimas dhe Çërravë sipas vendimeve përkatëse të Këshillit të Ministrave.

2. Sipërfaqja e tokës bujqësore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të administrohet sipas ligjit nr. 8318, datë 1.4.1988, “Për dhënien me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar, ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik/privat”, dhe vendimit nr. 460, datë 22.5.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe procedurave të dhënies me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”.

3. Në vendimin nr. 244, datë 4.4.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Buçimas, të qarkut të Korçës”, hiqet e drejta e përdorimit të pronës sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

4. Në vendimin nr. 417, datë 8.6.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Çërrave të qarkut të Korçës”, hiqet e drejta e përdorimit të pronës sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Në vendimin nr. 534, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Udenisht të qarkut të Korçës”, hiqet e drejta e përdorimit të pronës sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

6. Ngarkohen ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, ministri i Punëve të Brendshme dhe Këshilli i Qarkut të Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama